



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN - BASIC COURT OF PRIZREN

C.nr.248/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtarja Shpresa Emra, në kontestin e paditësit K. R. e U. R. -D. Sh.A.Gjakovë, të cilën e përfaqëson me autorizim L. K. nga Gjakova, kundër të paditurit Sh. Sh. nga Prizreni rr. , për shkak të borxhit, vlera e kontestit 764.90 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt. **17.09.2014** mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **PJESËRISHT APROVOHET** kërkespadija e paditësit K. R. e U. R. -D. me seli në Gjakovë.
- II. **OBLIGOHET** i padituri Sh. Sh. nga Prizreni, që në emër të borgjit të ia paguajë paditësit **shumën prej 243.00€**, me kamatë ligjore duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit me dhunë.
- III. Pjesa tjetër e kërkespadiës e paditësit, nga pjesa e aprovuar e gjer te pjesa e kërkuar **refuzohet si e pabazuar**.

A r s y e t i m

E autorizuarja e paditësit fillimisht ka parashtruar propozim për përmbarim në procedurën përmbarimore me të cilën ka kërkuar që i padituri të obligohet të paguaj kreditorit borxhin për shfrytëzimin e shërbimeve të K. R. të U. R. -D. nga Gjakova në shumë prej 764.90€. I padituri ndaj këtij propozimi ka parashtruar kundërshtim andaj propozimi i kreditorit tani konsiderohet si padi e paditësit. Në shqyrtimin kryesor e autorizuarja e paditësit ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës nga padia duke e plotësuar të njëjtën se në bazë të Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore respektivisht neni 8 lidhur me tarifën e ujitjes pronarët e tokave në zonat e ujitjes duhet t'i paguajnë shpenzimet për mirëmbajtje të rrjetit kryesor pa marrë parasysh se a e përdorin apo jo rrjetin për ujitje. Konsumuesit për ujitje në zonat e mbuluara me rrjet të ujitjes gjithashtu duhet t'i paguajnë shpenzimet e tilla. Pagesat duhet të inkasohen nga pronarët ose nga

konsumuesit e ujit për ujitje sa i përket tokave. I padituri duhet të paguaj borxhin për ujitje pasi që kjo kërkesë mbështetet në evidencën e librave të tokës bujqësore – regjistrit në të cilën figuron se Sh A Sh është pronar- posedues i parcelave 5902, 5903, 5900, 5901, 5770/5 dhe 595 ZK Prizren. Të gjitha të evidentuara në këtë liber dhe në bazë të kësaj evidence dhe nenit të lartcekur duhet të paguaj borxhin i cili kërkohet në padi. Në fjalën e saj të fundit e autorizuar e paditësit ka propozuar që gjykata të aprovoj kërkesë padinë në tërësi si të bazuar dhe të obligoj të paditurin të paguaj borxhin në shumë prej 764.90€ me kamatë si është cekur në padi. Shpenzimet I ka kërkuar sipas vlerësimit të gjykatës.

I padituri në përgjigje në padi ka cekur se ai në procedurën përmbarimore ka bërë kundërshtim ndaj propozimit për përmbarim ashtu që edhe tani në këtë kontest e kundërshton në tërësi kërkesë padinë duke cekur se është e vërtet që ai pjesërisht është pronar i parcelave për të cilat kërkohet të paguhet borxhi për shfrytëzimin e rrjetit të ujit por pjesërisht nuk është pronar. Disa parcela i shfrytëzon vëllau i tij Sh Sh me të cilin është bashkëpronar dhe kanë kontest tjetër për këtë palujtshmëri kurse në disa parcela ka të ndërtuara shtëpi të cilat më nuk janë tokë bujqësore por tokë e urbanizuar. Poashtu kërkesë padia e paditësit është kërkesë padi e vjetërsuar nga fakti se shuma e kërkuar nuk mund të jetë borxhi për vitin 2008 por sigurisht është borxh i bartur nga shumë vite të mëparshme dhe paditësi me kërkesë padi në fjalë është vonuar andaj gjykata duhet të kujdeset për këtë fakt dhe të merr parasysh se kemi të bëjmë me kërkesën e parashktruar. Në shqyrtimin kryesor i padituri ka deklaruar se ngel në tërësi pranë përgjigjes në padi të dhënë me shkrim dhe në lidhje me palujtshmëritë të cilët janë kontestuese dhe të cilat ujiten nga rrjeti i paditësit ka parashtruar çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe atë për parcelat kadastrale 5900 dhe 5901 të cilat janë të evidentuara në emër të KBI. Gjithashtu ai sipas paditësit ngarkohet edhe për palujtshmërinë të parcelës kadastrale 5770/5 e cila është dhënë gabimisht dhe kjo parcelë duhet të jetë me nr. 5770/3 ZK Prizren. Sa i përket parcelës kadastrale 5905 e njëjta është urbanizuar dhe nuk është më tokë bujqësore, si dhe ai nuk shfrytëzon dhe nuk i përdorë shërbimet e paditësit dhe nuk konsideron se ka borxh ndaj të njëjtit. Në fjalën e tij të fundit ai ka mbetur në tërësi pranë përgjegjes në padi dhe ka propozuar që gjykata të refuzoj kërkesë padinë si të pabazuar. I ka kërkuar shpenzimet dhe atë për përgjigje në padi 70€ dhe për kundërshtim 50€ si dhe shpenzimet e gjykatës sado që ato të jenë.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë shiqimin në kartelën e konsumatorit në emër të Sh Sh të dt. 26.08.2009, ka bërë leximin e faturës KRU në emër të Sh Sh për vitin 2005, ka bërë leximin e faturës së KRU R-D në emër të Sh Sh për vitin 2006, për vitin 2007 dhe për vitin 2008 të gjitha me datë 27.08.2009, ka bërë shiqimin në evidencën nga libri i regjistrit të tokës bujqësore faqja nr. 14 në të cilat janë evidentuar parcelat në emër të Sh A Sh, ka bërë shiqimin në çertifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme parcela nr. 5770/3 ZK Prizren, parcela nr. 5901 ZK Prizren dhe parcela nr. 5900 ZK Prizren dhe ka bërë leximin e kartelës së konsumatorit në

emër të Sh. A. Sh. në KRU "R" D të dt.
21.11.2011.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Me shqimin në dokumentacionin të cilën e ka parashtruar e autorizuar e paditësit dhe atë kartela konsumatorit dhe faturat për vitin 2006, 2007, dhe 2008 gjykata vërtetoi se të gjitha këto dokumente janë të evidentuara në emër të Sh. A. Sh. nga Prizreni dhe kërkohet borxhi për shfrytëzimin shërbimeve të paditësit respektivisht ujitjes së sipërfaqes tokësore e cila është e cekur në kartelën e konsumatorit duke filluar nga viti 2005 gjerë më vitin 2009. Për vitin 2005 borxhi është 148.90€, për vitin 2006 126.00€, për vitin 2007 251.00€ dhe fatura e vitit 2008 është në shumë prej 253.00€

Me shqimin në evidencën nga libri I regjistrin të tokave bujqësore në emër të Sh. A. Sh. në faqen 14 janë të evidentuara parcelat 5902 në sipërfaqe prej 23 ari, parcela 5903 në sipërfaqe prej 35 ari, parcela 5901 në sipërfaqe prej 19 ari, parcela 5770/5 në sipërfaqe prej 26 ari dhe parcela 5905 në sipërfaqe prej 0.71 ari.

Me shqimin në listat poseduese të parashtruara nga ana e të paditurit gjykata vërtetoi se palujtshmëria parc. Kad.nr. 5901 evidentohet në emër të KBI , parc. Kad.nr. 5900 evidentohet në emër të KBI dhe parc. Kad. 5770/3 evidentohet në emër të KBI të gjitha gjenden në vendin e quajtur "Ç" KK Prizren.

Me shqimin në kartelën e konsumatorit parashtruar nga ana e të paditurit e cila është e dhënë nga ana e KRU R -D Gjakovë me dt. 21.12.2011 gjykata vërtetoi se e njëjta është evidentuar në emër të Sh. A. Sh. dhe është cekur që fatura për vitin 2005 është 230.46€.

Vlerësimi juridik

Gjykata pas administrimit të provave të lartcekura secila veç e veç dhe të gjitha bashkarisht vërtetoi gjendjen faktike si vijon;

Nuk është kontestuese se I padituri është posedues I disa parcelave me culture arë të cilat janë të evidentuara në regjistrin e tokave bujqësore e cila shfrytëzohet për ujitje. Padituri ka pranuar se ai është posedues dhe pronar I disa palujtshmërive kadastrale por nuk ka pranuar faktin se është pronar I të gjitha parcelave për të cilat paditësi e obligon që të paguaj për ujitje nga cila deklaratë gjykata konstaton se I njëjti ka shfrytëzuar shërbimet të paditësit për ujitje të tokës bujqësore dhe se I njëjti është I evidentuar në librat e regjistrin të tokave për ujitje. Gjykata pas shqimit në faturat e parashtruara nga ana e paditësit ka vërtetuar faktin se kërkohet borxhi duke filluar na viti 2005 gjerë më vitin 2009. Propozimi për përmbarrim është parashtruar me date 19.10.2009 dhe nga ky fakt

konstatohet se parashtrimi i kërkesës për pagesën e borxhit është parashkruar sa I përket viteve 2005,2006, 2007 pasi që kërkesa është parashtruar pas afatit ligjor të paraparë me dispozita të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077 neni 360 par 1 nën par 1 ku ceket **“se parashkruhen për 1 (një) vit kërkesat e kompensimit përshfrytëzimit të energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit, për shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”** sa i përket borxhit të vitit 2008 këtë e ka aprovuar pasi që kërkesa për pagimin e borxhit për këtë vit është e afatshme dhe I padituri obligohet që këtë borxh të paguaj në shumë prej 243€ bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) respektivisht në nenin 8 ku ceket se **“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”**, ndërsa me nenin 245 të po këtij ligji, është paraparë se **“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”**, andaj nga këto arsye u vendos si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.Sa i përket kamatës është vendosur në bazë të nenit 378 të LMD që parasheh pagesën e borxhit me kamatë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 8 dhe 245 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.248/12 dt. 17.09.2014

Gjyqtarja
Shpresa Emra



UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.